

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 41-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 21.12.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë:** L Lazar Trajçev (mungesë me arsye).

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional:**mr.Dragica Ljubevska,Cvetanka Mitrevska, Emilija Janevska, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska.

**Të pranishmit e tjerë :** /

Z. Petrushevski hapi seancën e 41-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 5 vota “pro”, miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 40-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 21.12.2023.
2. Propozim-plani vjetor për furnizim publik në vitin 2024 i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TELEVISIONI MAKPETROL SHPKNJP Shkup, për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe të nenit 22 paragrafi (2) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TELEVISIONI MAKPETROL SHPKNJP Shkup, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR Televizionit SITEL SHPKNJP Shkup, për shkelje të nenit 53 paragrafi (2) të LSHMAAV.
6. Propozim-përgjigje të njoftimit nga SHTR Radio Kanal 77 SHPKNJP Shtip.
7. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për miratimin e mjeteve financiare për furnizim të shërbimeve avokatie.
8. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë për arsye teknike ka shtyrë Procesverbalin e propozuar nga seanca e 40-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.12.2023, për para fillimit të seancës së radhës.

## **Pika 2**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska ka shpjeguar Propozim-planin vjetor për furnizim publik në vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Ajo ka shpjeguar se Agjencia në pajtim me dispozitat e Ligjit për furnizim publik ka obligim që pas miratimit të Planit financiar të Agjencisë për vitin 2024, të miratojë Planin vjetor për furnizim publik i cili do të përcaktojë të gjitha furnizimet që Agjencia do të ketë nevojë t'i zbaton gjatë vitit. Forma dhe përmbajtja e planit është përcaktuar me Rregulloren për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së Planit vjetor për furnizim publik të Ministrit të Financave. Pas miratimit të Planit vjetor gjatë vitit 2024, ai mund të ndryshohet ose plotësohet sipas mjeteve të parashikuara. Plani i miratuar për furnizim publik, Agjencia është e obliguar ta publikojë në sistemin elektronik për furnizim publik më së voni deri në fund të janarit 2024.

Z. Petrushevski pyeti nëse mund të katë problem me zbatimin e Planit vjetor për Furnizim publik për shkak të zgjedhjeve të shpallura për vitin 2024?

Udhëheqësja Mitrevska shpjegoi se këto furnizime që janë paraparë në Planin vjetor për furnizim publik nuk do të ketë problem për realizimin e tyre, por gjatë zgjedhjeve nuk mund të bëhen ndryshime dhe plotësime.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha pëlqim për miratimin e Planit vjetor për furnizim publik në vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Planin vjetor të mësipërm për furnizim publik në vitin 2024, ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pikat 3 dhe 4**

Z. Petrushevski propozoi që propozimet për shqiptimin e masës vërejtje publike për SHTR TELEVISIONI MAKPETROL SHPKNJP Shkup, për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 22 paragrafi (2) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve dhe për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media të shpjegohen dhe diskutohen në një hyrje ndërsa votimi të bëhet për secilën pikë veç e veç.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr.Emilija Janevska, shpjegoi se dy shkeljet e TV Telma janë konstatuar nga mbikëqyrja e rregullt e kryer më 7 nëntor të këtij viti. Nga mbikëqyrja programore është konstatuar shkelja e nenit 50 paragrafit (3) të LSHMAAV dhe nenit 22 paragrafit (2) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve sepse më 7 nëntor 2023, dy blloqe publikim/njoftim për program artistik nuk janë shënuar me sinjalistikë paralajmërimi përkatës për klasifikimin e kategorisë së programit të planifikuar për shfaqje. Sa i përket mbikëqyrjes administrative, ajo shpjegoi se është konstatuar shkelja e nenit 14 të Ligjit për Media, pasi që në 7 nëntor 2023 transmetuesi nuk ka publikuar të dhënat për impresium në filmin dokumentar “Истражи ја Кина”(Eksploro Kinën). Për dy shkelje propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike me afat respektimi prej 20 ditësh dhe më pas të kryhet mbikëqyrje

kontrolli për të përcaktuar nëse transmetuesi ka vepruar sipas masave të shqiptuara. Ajo ka shpjeguar se transmetuesi ka dorëzuar deklaratë lidhur me dy raportet e mbikëqyrjes. Sa i përket shkeljes së parë për sinjalistikën paralajmëruese në njoftimet promovuese, thuhet se gabimi nuk ka qenë i qëllimshëm pasi nuk e kanë ditur që në njoftimet promovuese që nuk përmbajnë skena eksplicite të dhunës është e nevojshme të publikohet sinjalistika (shenja) paralajmëruese dhe se gabimi tashmë është korrigjuar. Në lidhje me nenin 14 të LM, ata thonë se përgjegjësia për shkeljen e ka bashkëpunëtori i tyre, kompania prodhuese e filmit dokumentar, ndërsa nga kompania po ashtu është bashkangjitur shkresë në deklaratën e TV Tëlmës, se ka qenë gabim teknik i bërë gjatë redaktimit dhe që në të ardhmen nuk do të përsëritet.

### Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4476/1 të datës 01.12.2023 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TELEVISIONI MAKPETROL Shkup, t'i shqiptojë masën vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe të nenit 22 paragrafi (2) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve(fëmijëve) sepse më 7 nëntor 2023, dy blloqe publik/njoftim për program artistik nuk ishin shënuar me sinjalistikën e duhur paralajmëruese për klasifikimin e kategorisë së programit të planifikuar për shfaqje.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është udhëzuar që brenda 20 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Rregulloren për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimi e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

### Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative nr.10-4458/1 të datës 01.12.2023 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TELEVISIONI MAKPETROL Shkup, t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media sepse më 7 nëntor 2023 nuk publikoi të dhënat për impresium në filmin dokumentar (Eksploro Kinën) "Истражи ја Кина".

Në pajtim me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është udhëzuar që brenda 20 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimi e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 5**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR Televizioni SITEL SHPKNJP Shkup, për shkelje të nenit 53 paragrafi (2) të LSHMAAV. Ajo ka shpguar se edhe kjo shkelje është konstatuar nga e njëjta mbikëqyrje e rregullt programore e kryer më 7 nëntor. Neni 53 paragrafi (2) ndalon komunikimet e fshehta komerciale audiovizuale, por transmetuesi më 7 nëntor 2023, në pjesë të emisinit të mëngjesit informativ-argëtues “Ja сакам Македонија” (E dua Maqedoninë) ka transmetuar komunikim të fshehtë komercial audiovizual për produkt të firmës (kompanisë) “Comodita Home”. Për atë arsye propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike dhe sipas Udhëzimit afati për këtë lloj të shkeljes është menjëherë pas pranimit të aktvendimit dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të parë nëse ka vepruar sipas masës. Ndërsa TV Sitel dërgoi deklaratë në të cilën thuhet se shkelja ka ardhur për shkak të koordinimit të pamjaftueshëm ndërmjet ekipeve të tyre të punës dhe se pas marrjes së raportit kanë vazhduan me përmirësimin e procesit të përgjithshëm të punës ndërmjet njërive të tyre.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4474/1 të datës 01.12.2023 dhe njëzëri konstatoi që SHTR Televizioni SITEL SHPKNJP Shkup t'i shqipton masën vërejtje publike për shkelje të nenit 53 paragrafi (2) të LSHMAAV për shkak se më 7 nëntor 2023, në pjesë të emisionit të mëngjesit informativ-argëtues "E dua Maqedoninë" është transmetuar komunikim i fshehtë komercial audiovizual për produkt nga kompania “Comodita Home”.

Në pajtim me pikën 4 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është udhëzuar menjëherë pas marrjes së aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 6**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr.Emilija Janevska shpjegoi Propozim-përgjigjen e njoftimit nga SHTR Radio Kanal 77 SHPKNJP Shtip. Ajo shpjegoi se më 6 dhjetor Kanali 77 i ka dërguar shkresë ASHMA-së dhe individualisht të gjithë anëtarëve të Këshillit, e cila ka të bëjë me procedurën e nisur dhe të ndaluar më parë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Kanalit 77, domethënë është e lidhur me praktikën që transmetuesi e quan reklamim i ndarë. Shkresa është në materiale, por është e rëndësishme të thuhet se transmetuesi ka keqinterpretuar plotësisht legjislacionin ligjor, si vendas ashtu edhe europian, dhe përmes një keqinterpretimi të dispozitave kërkon që Këshilli të lejojë sërish ritransmetimin në rajone të ndryshme të vendit reklama të ndryshme. Ajo shpjegoi se është e rëndësishme në përgjigjen që do t'i dërgohet të theksohet se Agjencia në asnjë moment, as në Raportin e mbikëqyrjes dhe as në dokumente të tjera nuk ka vënë shenjë barazie të termave audio ose program në radio me komunikimin komercial audiovizual, përkundrazi është fakt famëkeq se komunikimet komerciale dhe programi nuk janë të lidhura dhe se janë terma krejtësisht të ndryshëm të definuar. Ajo gjithashtu sugjeroi që në shkresë transmetuesi të rikujtonte se cili ishte thelbi i shkeljes, që është se nuk transmetoi një/të vetëm shërbim programor në radio në të gjithë territorin për të cilin ka marrë lejen, të rikujton përkufizimin e shërbimit programor se është një tërësi programesh, komunikimesh komerciale dhe elemente të tjera dhe se nga vetë përkufizimi është e qartë se praktika që ai e quan reklama të ndara është në kundërshtim me rregullativën ligjore. Gjithashtu duhet thënë se reklamimi në ekran të ndarë nuk është i ndaluar me LSHMAAV siç pretendon transmetuesi në shkresë, përkundrazi është një praktikë e inkurajuar nga ligji. Në nenin 98, është formuluar dispozita për të mos kufizuar përdorimin e teknikave të reja të reklamimit, prandaj kjo ndarje e reklamave nga programet përveç kohës mund të jetë dhe hapësinore. Në Rregullore të veçantë për teknikat e reja të reklamimit, janë rregulluar edhe reklamat me ekran të ndarë dhe reklamat virtuale, reklamat interaktive dhe forma të tjera, por është e rëndësishme që këto forma reklamimi janë të lejuara vetëm për shërbimet mediatike audiovizuale, jo dhe për shërbimet audio me ekran të ndarë në Ligjin përkufizohet si shfaqja e njëkohshme e një programi audiovizual dhe e një reklame në ekran në pjesë të ndryshme të ekranit. Atë që transmetuesi e quan “ split reklama ”, ose reklamim i ndarë, në praktikë përdoren terma të tjera që nuk kanë lidhje me rregullativën evropiane. Ajo shpjegoi se e hetoi çështjen për të dhënë më shumë informacion dhe ky është një debat që po zhvillohet në Shtetet e Bashkuara, Komisioni Federal i Komunikimeve nga Amerika në vitin 2020 ka hapur një debat publik të nxitur nga zhvillimi teknologjik dhe shërbime të tjera të ofruara nga kompanitë e mëdha nëse t'i lejohet radiove lokale të munden në çdo 5 minuta në orë të plasojnë përmbajtje të synuara. Debatit publike ende nuk ka përfunduar, Komisioni Federal i Komunikimeve të Amerikës nuk ka marrë vendim nëse do ta lejojë këtë, sepse ka diskutime serioze për këtë çështje. Ajo shpjegoi se gjeti shumë reagime për këtë temë, dhe disa nga reagimet atë e përshkruan si presionin e teknologjive të madhe ndaj fjalës së lirë në Amerikë. Është interesant fakti se dhe Organizata Kombëtare e Transmetuesve është kundër një zgjidhjeje të tillë, pasi sipas tyre, kjo jo vetëm që do të prishë sistemin e tyre kombëtar për alarmimin e situatave emergjente, i cili ndoshta është i lidhur, për shembull, në vendin tonë me Qendrën e Menaxhimit të Krizave me mënyrën e sinjalizimit, dhe me siguri aty transmetuesit kanë detyrime të veçanta në lidhje me atë sistem dhe ndoshta kjo do të ndikojë në prishjen e atij sistemi, megjithatë thonë se kjo do të çojë në segmentimin e mëtejshëm të tregjeve lokale të reklamave por edhe në uljen e të ardhurat nga reklamat sepse në këtë mënyrë reklamuesit do të stimulohen të mos shpenzojnë shumë para për marketing në nivel kombëtar, por të shkojnë në vende të synuara me të ardhura më të ulëta. Ajo përsëriti se diskutimi nuk ka përfunduar ende, pritet që deri në fund të këtij viti apo në vitin e ardhshëm të mirret vendim nëse do të lejohet atje. Megjithatë, nuk ka të bëjë me rregullativën dhe praktikën

evropiane në të cilën bazohet rregullativa jonë. Ajo beson se në përgjigje transmetuesit duhet t'i kujtohet se një praktikë e tillë nuk ka qenë pjesë e raportit të mbikëqyrjes sepse me këtë nuk mund të konstatohet me raportin e mbikëqyrjes të përgatitur nga Sektori për çështjeve programore, por duhet përkujtuar se një sjellje e tillë nuk është konkurrencë e drejtë në raport me transmetuesit rajonalë dhe lokalë në vendin tonë, të cilët duhet të mbijetojnë nga ato tregje që synon tashmë të jenë në shënjestër të transmetuesit kombëtar.

Z. Petrushevski tha se është e qartë se është bërë shumë përpjekje për t'i dhënë përgjigje cilësore transmetuesit dhe deklaroi se do ta mbështesë përgjigjen e propozuar.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi përmbajtjen e Shkresës nga SHTR Radio Kanal 77 SHPKNJP Shtip, e cila i referohet "transmetimit të përmbajtjeve reklamuese sipas parimit të reklamimit të ndarë", dorëzuar në Agjenci (nr. ynë 08-331, datë 06.12.2023) dhe njëzëri vendosi t'i përgjigjet transmetuesit se mbetet i të njëjtit mendim dhe qëndrime që janë shprehur në seancën e 32-të të datës 9 tetor 2023, gjegjësisht se është e nevojshme që transmetuesi të veprojë në pajtim me lejen e dhënë për transmetim shërbimit programor në radio dhe në të gjithë territorin për të cilin ka leje duhet të transmetojë shërbim programor identik, pra një/të vetëm, i cili sipas nenit 3 paragrafi (1) pika 12 të LSHMAAV përcaktohet si - " grup programesh dhe elemente të tjera të një shërbimi të vetëm mediatik audio ose audiovizual".

Përgjigja e mësipërme t'i dorëzohet drejtuar SHTR Radio Kanal 77 SHPKNJP Shtip.

#### **Pika 7**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për miratimin e mjeteve financiare për furnizim të shërbimeve avokatie. Ai shpjegoi se kjo zyrë avokatie është e angazhuar për të tretin vit nga rregullatori dhe si drejtor është shumë i kënaqur me shërbimet që ofrojnë, gjithmonë u përgjigjen thirrjeve të Agjencisë kur është e nevojshme, si konsultime, këshilla juridike, veçanërisht ndihmon Agjencinë në pjesën e punës jo vetëm të sektorit juridik por edhe të sektorëve të tjerë kur kanë nevojë për përgjigje në gjykatën administrative apo kushtetuese për procedurat gjyqësore që duhet të udhëheqë Agjencia.

Z. Petrushevski tha se ky furnizim i shërbimeve avokatie është i dobishëm edhe për Këshillin e Agjencisë, kur ata marrin vendime përveç mendimit të tyre, mendimit të shërbimit dhe drejtorit, të ketë dhe një kontroll profesional që të jenë të saktë në marrjen e vendimeve ose akteve nënligjore.

Këshilli i Agjencisë për nevojat e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, njëzëri ka dhënë miratimin që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për furnizim të shërbimeve avokatie për vitin 2024.

Për furnizimin e shërbimeve avokatie (juridike), janë miratuar mjete financiare në vlerë prej 500,00 0,00 denarë (me TVSH) , të cilat janë të parapara në Planin financiar të Agjencisë për vitin 2024.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale me subjektin që plotëson kushtet e kërkuara, do të lidhë një kontratë e cila do të rregullojë marrëdhëniet e ndërsjella të dy palëve kontraktuese.

#### **Pika 8**

**Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-4656/7**

**26.12.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,**

---

**Lazo PETRUSHEVSKI**